

Vllaznia i dhuron kryesimin Kukësit

nga Albaniassocer

E shtunë, 24 Janar 2015 18:50



Vllaznia-Kukësi 1-2 Pejçic 6,Lushtaku 59,Kalaja 66

Ekipi shkodran me ane të Sykajt i dhuroi një gol të shpejtë Pejçicit të Kukësit.

Ndeshja në Shkodër hapet me golin e shpejtë të Kukësit por mund të thuhet se ishte një dhuratë e Sykajt për Pejçicin. Nga një goditje këndit mbrojtësi shkodran gabon goditjen me këmbë dhe i dhuron topin Pejçicit që nuk falë Selimajn nga fare afër. Vllaznia mundohet të reagojë por pa arritur të rrezikonte portën e Halilajt. Në pjesën e dytë Kukësit dyfishon rezultatin me një goditje të lirë spektakolare të Lushtakut. Në dizavantazh të dy golave u duk sikur shkodranët u zgjuan dhe fituan një penallti shumë të dyshimte për një faull me dorë të Dushkut. Shtubina e merr për sipër realizimin por gjuajtja e tij pritet nga Halilaj. Pas këtij episodit është i riu Kalaja që me një levizje të bukur shmang mbrojtjen kuksiane dhe shënon një gol shumë të bukur. Si për të konfirmuar mbremjen negative të tij Shtubina shpërdoron një tjetër rast shënimit pranë portës kuksiane. Dy raste të thjeshta patën edhe Kuksianët me Lushtakun dhe Pejçicin por nuk arritën dot të thellonin rezultatin.